

La Rubrica Legal

La rubrica in cui i professionisti di freebly approfondiscono e commentano la loro materia



MALBORA GJOKA

malbora.gjoka@freebly.com

COMPLIANCE & MANAGEMENT PJESA II

ISO (INTERNATIONAL ORGANIZATION FOR STANDARDIZATION)

ISO eshte nje nga organizatat me te rendesishme ne nivel nderkombetar per krijimin dhe parashikimin e normave teknike - organizative ne fushen e fushen e industrijeve dhe tregtise. Qellimi i saj kryesor eshte ai i harmonizimit e standartizimit te veprimtarise produktive ne nivel boteror.

E themeluar me 23 shkurt 1947 ne London, kryen funksione konsultimi per UNESCO-n dhe Organizatene e Kombeve te Bashkuara (OKB). Me zyre qendore ne Sviser eshte e perbere nga perfaquesuesit e plot 164 shteteve.

Veprimtaria e saj operative eshte e konkretizuar nga aktiviteti i **komiteteve teknike** te ndare sipas kompetencave dhe perfaquesuesve nderkombetar. Per arritjen e objektivit te saj final, ISO krijon dhe implementon modele organizative standart me qellim aplikimin e tyre ne te gjitha realitetet produktive e tregtare pamvaresisht natyres se aktivitetit apo territorit ku ato operojne.

Duke konsideruar faktin qe sot Shqiperia eshte gjithnjë e me teper e orientuar ne zhvillimin e marrdhenieve jo vetem lokale por edhe internationale eshte momenti i duhur qe nje ndermarrje tregtare apo çfardo lloj strukture tjeter juridike te kujdeset gjithnjë e me teper jo vetem per aplikimin e normave teknike por edhe per mire menaxhimin, organizimin dhe administrimin e personave e proceseve qe reflektojne aktivitetin e tyre.

Ky kujdes nuk duhet aspakt nenveresuar pasi efektet e tij prekin efikacitetin dhe vete jetegjatesine e ndermarrjes. Per sa i perket ketyre aspektave, doja te sillja disa reflektime qe vete ISO ne normen

37301:2021 “Compliance management systems – Requirements with guidance for use”, e publikuar ne muajin prille te ketij viti, i paraqet ne pjesen hyrese te saj.

“Te gjithe ato ndermarrje/organizata qe kane si objektiv suksesin e tyre te vazhdueshem duhet te parashikojne dhe te zhvillojne “kulturen e Compliance” (ndr. kulturen e respektimit te rregullave), duke pasur parasysh nevojat dhe interesat e paleve te perfshira ne realitetin e saj. Te jesh Compliance (ndr. konform) nuk eshte vetem basa e çdo aktiviteti por dhe nje mundesi positive per suksesin dhe stabilitetin e çdo ndermarrje apo organizate ne pergjithesi.

Konformiteti eshte nje proces i vazhdueshem dhe eshte resultat i nje organizate qe respekton detyrimet e saj. Compliance behet i qendrueshem atehere kur integrohet ne kulturen e ndermarrjes tregtare, ne sjelljen e njerezve qe e perbejne ate. Nderkohe qe menaxhimi i konformitetit mban pamvaresine e tij, ai duhet te integrohet me te gjithe proceset dhe procedurat e tjera qe jane pjesa e jetes se ndermarrjes.

Nje ndermarrje tregtare ose nje organizate qe disponon nje sistem efiçent te menaxhimi te konformitetit, i jep mundesine asaj te tregoj materjalish impenjimin konkret te saj per respektimin e ligjit ne pergjithesi, respektimin e kerkesave dhe detyrimeve specifike ligjore, te kodeve te ndryshme industriale, te standardeve organizative te njoitura ne mbar boten, te etikes dhe mir qeverisjes si dhe te respektimit te interesave te komunitetit ne pergjithesi.”

E kush nuk do deshironte te krijonte nje bisnes apo çfaredolloj marredhenie fitimprurese me nje subjekt te till...?